



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ Datë ____/____/202__

**PËR
MIRATIMIN E LISTES EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE
PËR PËRFITIMIN E BURSIVE DHE PAGESAVE
PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, nenit 28, pika 4 shkronjat a, b dhe d të ligjit nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 32, pika 2, të ligjit nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 2, të ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, nenit 6, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr.8098, datë 28.03.1996, "Për statusin e të verbërit" të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr.8626, datë 22.06.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" të ndryshuar, nenit 5, të ligjit nr.10289, datë 17.06.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 666, datë 10.10. 2019 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim e bursave e të pagesave për nxënës të arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në Institucionet Arsimore Parauniversitare Publike" i ndryshuar, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr.389, datë 03.11.2025 "Për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për përfitim burse dhe pagese për nxënës të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2025-2026", si dhe sipas relacionit të përgatitur nga ky komision, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË :

1. Miratimin e listës emërore të nxënësve të Shkollave 9-vjeçare që plotësojnë kriteret ligjore për përfitim e bursës, për vitin shkollor 2025-2026, sipas tabelës nr.1, Lista emërore e nxënësve të Shkollave 9-vjeçare me nr. rendor nga 1-631, bashkalidhur.

2. Miratimin e listës emërore të nxënësve të Shkollave të Mesme të Përgjithshme të Bashkisë Durrës, Shkollës së Orientuar Sportive “Benardina Qerraxhia” si dhe konviktit të kësaj shkolle, që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës për vitin shkollor 2025-2026, sipas tabelës nr.2, Lista emërore të nxënësve të Shkollave të Mesme dhe konviktit të shkollës “B.Qerraxhi” me nr. rendor nga 1-170, bashkalidhur.
3. Miratimin e listës emërore të nxënësve të vitit të parë që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës për vitin shkollor 2025-2026, të Shkollës së Mesme Teknologjike “Hysen Çela”, të Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela”, të Shkollës së Mesme Profesionale Kombëtare “Charles Telford Ericson”, Golem Kavajë sipas tabelës nr.3, Lista emërore e nxënësve të vitit të parë që propozohen si përfitues burse në Shkollën e Mesme Teknologjike “Hysen Çela”, Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela”, dhe në Shkollën e Mesme Profesionale Kombëtare “Charles Telford Ericson”, Golem Kavajë me nr.rendor nga 1-58, bashkalidhur.
4. Miratimi listës emërore e nxënësve të vitit të dyta e lart që vazhdojnë bursën, të Shkollës së Mesme Teknologjike “Hysen Çela” dhe Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela” për vitin shkollor 2025-2026 sipas tabelës nr. 4, Lista emërore e nxënësve të vitit të dyte e lart që vazhdojnë bursën në Shkollën e Mesme Teknologjike “Hysen Çela”, Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela” me nr. rendor nga 1-267, bashkalidhur.
5. Miratimin e numrit të nxënësve dhe mësuesve për shkollën speciale PLM, ku numri i nxënësve dhe fëmijëve të regjistruar është 110 dhe i mësuesve përfitues është 30, për vitin shkollor 2025-2026.
6. Ngarkohet Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

PËR DREJTORINË LIGJORE

DREJTORIA E ARSIM- KULTURË RINI-SPORT E KOM. FETARE

Drejtore

Alinda Roshi

Drejtore

Migena Muhaj

KRYETAR

Emiriana Salaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

KËSHILLIT BASHKIAK

RELACION

Për miratimin e listës emërore të nxënësve të arsimit parauniversitar, që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursave dhe pagesave për vitin shkollor 2025-2026

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja b, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të këtij ligji, nenit 113, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 28, pika 4 shkronjat a, b dhe d të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 32, pika 2, të ligjit nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 2, të ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, nenit 6, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit” të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr.8098, datë 28.03.1996, “Për statusin e të verbërit” të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr.8626, datë 22.06.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” të ndryshuar, nenit 5, të ligjit nr.10289, datë 17.06.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, VKM 666/2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në Institucionet Arsimore Parauniversitare Publike” të ndryshuar, u krijua Komisioni i shqyrtimit të kërkesave të nxënësve të Arsimit Parauniversitar, me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Nr.389, datë 03.11.2025 “Për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për përfitim burse dhe pagese për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2025-2026”. Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr.6642 prot., datë 17.10.2025, protokolluar në Bashkinë Durrës me nr.12819 prot., datë 22.10.2025 ka kërkuar nga bashkia të planifikojë dhe dërgojë numrin e bursave që kërkon për nxënësit e arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026. Komisioni shqyrtoi shkresën e Sektorit të Arsimit në Bashkinë Durrës me nr.12819/1 prot., datë 24.10.2025, ku i ka kërkuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të planifikojë 760 bursa për institucionet arsimore parauniversitare të kësaj bashkie. Kërkesa shkresore është mbështetur në kriteret e VKM-së 666/2019, të ndryshuar si dhe në numrin faktik të përfituesve të bursave nga Bashkia Durrës në dy vite paraardhëse.

Referuar planit të bursave të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për Bashkinë Durrës i cili është 320 bursa për nxënësit që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, si për vitin shkollor 2023-2024 ashtu dhe 2024-2025, nisur dhe nga fakti që gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar që plotësojnë kriteret e VKM-së 666/2019 të ndryshuar, miratuar me VKB nr.196 dhe VKB nr.116 tejkalojnë planin e miratuar të bursave si më sipër, dhe në vitin shkollor 2023-2024 nxënësit kanë marrë vetëm 48% të bursës megjithë shkresat e bëra nga ne në drejtim të MAS, bashkia në zbatim të pikës 5 të VKM 666/2019 vendosi në buxhetin e saj një fond prej 25,294,464 lekë dhe mbuloi të gjithë nxënësit e miratuar me VKB nr. 116, datë 24.12.2024 për vitin shkollor 2024-2025.

Në bazë të shkresës me nr.7094/1prot., datë 06.11.2025 të Ministrisë së Arsimit protokolluar në Bashkinë Durrës nr. 13745 prot., datë 10.11.2025, plani i bursave të miratuara për vitin shkollor 2025-2026 është 300 bursa, duke mos e marrë fare parasysh kërkesën tonë. Mbështetur në dy vitet e kaluara dhe aplikimet e kryera për vitin shkollor 2025-2026, Drejtoria e Arsimit Kulturës me shkresën nr.14925 prot., datë 09.12.2025 i ka kërkuar Drejtorisë së Buxhetit vendosjen e një fondi 27,388,755 lekë për të plotësuar nxënësit që plotësojnë kriteret e VKM 666/2019 të ndryshuar që do të miratohen brenda muajit dhjetor 2025 nga Këshilli Bashkiak në zbatim të VKM 666/2019 të ndryshuar.Gjithashtu Komisioni shqyrtoi shkresën nr.5379/4 prot., datë 29.10.2025 të Ministrisë së Brendshme protokolluar në Bashkinë Durrës me nr. 13365 prot., datë 03.10.2025 në lidhje me listën e fëmijëve të punonjësve të Policisë së Shtetit, përfitues sipas VKM-së nr.666, datë 10.10.2019 për nxënësen Daniela Ramadan Hilaj klasa e XI të shkollës së mesme “Naim Frashëri “Durrës.

Pas verifikimeve të dokumentave të paraqitura dhe të protokolluara në Bashkinë Durrës nga të gjitha shkollat publike të arsimit parauniversitar (9 vjeçare dhe të mesme të përgjithshme si dhe të mesme të orientuara artistike dhe sportive, komisioni shqyrtoi dhe kërkesën e prindërve të nxënëses së shkollës 9 vjeçare “14 Nëntori” që kanë dorëzuar dokumentat direkt në Bashkinë Durrës, në zyrën e marrëdhënieve me publikun. Dokumentacioni i protokolluar në Bashkinë Durrës është përshkruar në mënyrë të detajuar në procesverbalin e mbajtur nga ky komision me datën 15.12.2024, bashkëlidhur këtij relacioni.

Numri i aplikimeve nga shkollat 9 vjeçare dhe të mesme pranë Bashkisë Durrës është 918 nxënës, propozohen pasi plotësojnë kriteret e VKM-së, mbështetur me dokumentacion 801 nxënës.

Kanë dorëzuar dokumentacionin nga shkollat 9 vjeçare 734 aplikantë:

- Propozohen pasi plotësojnë kriterin të mbështetur me dokumentacion 631 aplikantë
- Kanë mungesa në dokumentacion 103 aplikantë

Kanë dorëzuar dokumentacionin nga shkollat e mesme 184 aplikantë

- Propozohen pasi plotësojnë kriterin të mbështetur me dokumentacion 170 aplikantë
- Kanë mungesa në dokumentacion 14 aplikantë

Komisioni bëri shqyrtimin dhe miratimin e listave emërore të nxënësve në arsimin parauniversitar në institucionet publike, sipas kontrollit të dokumentacionit duke listuar të gjithë nxënësit, kandidatë për përfitim burse për vitin shkollor 2025-2026 si më poshtë:



1. Lista emërore e nxënësve për përfitim burse për vitin shkollor 2025-2026, të shkollave 9 vjeçare në tabelën nr.1, bashkëlidhur.
2. Lista emërore e nxënësve për përfitim burse për vitin shkollor 2025-2026 të shkollave të mesme të përgjithshme, si dhe të orientuara artistike dhe sportive të cilët plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës nga kriteret e VKM nr. 666/2019, të ndryshuar në tabelën nr.2 bashkëlidhur.

Komisioni bëri shqyrtimin e listave emërore të nxënësve në arsimin parauniversitar në institucionet publike, sipas kontrollit të dokumentacionit duke listuar të gjithë nxënësit, kandidatë për përfitim burse për vitin shkollor 2025-2026 sipas kriterëve të VKM-së.

Numri i nxënësve që propozohen nga shkollat 9 vjeçare dhe të mesme të përgjithshme, si dhe të orientuara artistike dhe sportive si përfitues të kriterëve të VKM 666/2019, të ndryshuar janë si më poshtë:

Kriteri	Shk.9 vjeçare	Shk.mesme+konvikti B.Qerraxhi	Gjithsej
Kriteri 2.3/a	18	2	20
Kriteri 2.3/b	11	3	14
Kriteri 2.3/c	136	15	151
Kriteri 2.3/ç	2	-	2
Kriteri 2.3/d	231	66	297
Kriteri 2.3/g	233	83	316
Kriteri 2.3/ë	-	1	1
Gjithsej	631	170	801

Për sa më sipër, bazuar në VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të përditësuar, Komisioni vendosi t'i propozojë Këshillit Bashkiak miratimin e listave emërore si më poshtë:

I. Lista emërore e nxënësve të shkollave 9-vjeçare që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës, për vitin shkollor 2025-2026, sipas tabelës nr.1 (Lista emërore e nxënësve të shkollave 9-vjeçare, me nr. rendor 1-631) bashkëlidhur.

II. Lista emërore e nxënësve të shkollave të mesme të përgjithshme të Bashkisë Durrës, shkollës së orientuar sportive "Benardina Qerraxhia" si dhe konviktit të kësaj shkolle, që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës për vitin shkollor 2025-2026, sipas tabelës nr. 2 (Lista emërore e nxënësve të shkollave të mesme dhe konviktit të shkollës "B.Qerraxhi" me nr. rendor 1-170) bashkëlidhur.

Gjithsej janë 801 nxënës të cilët propozohen për përfitues burse nga shkollat e 9 vjeçare dhe të mesme pasi plotësojnë kriteret e VKM 666/2019 të përditësuar nga të cilët kemi 22 nxënës që plotësojnë kriterin 2.3/a dhe 2.3/ç dhe përfitojnë dhe nga pika 17 (nxënësit, të cilët kanë përfituar statusin ligjor të jetimit, nxënësit e Institutit të fëmijëve që nuk dëgjojnë dhe që nuk shikojnë, përfitojnë çdo vit falas veshmbathje, libra dhe fletore, sipas kuotës financiare të përcaktuar në pasqyrën nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi).

Me shkresën nr. 973/1 prot., datë 29.10.2025 të Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit protokolluar në Bashkinë Durrës me Nr.13290 prot., datë 31.10.2025 dërgohet plani i shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë (klasën e dhjetë) në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2025-2026, i cili për Bashkinë Durrës, për këtë vit shkollor është 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) bursa.

Në zbatim të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të përditësuar, Komisionet e ngritura pranë shkollave të mesme profesionale me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Nr.376, datë 27.10.2025 "Për ngritjen e komisioneve pranë Shkollave të Mesme Teknologjike, Profesionale dhe Sportive të qytetit të Durrësit, për shqyrtimin e kërkesave për përfitim burse dhe pagese për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2025-2026", kanë shqyrtuar kërkesat e ardhura pranë tyre nga nxënësit përkatës, në zbatim të VKM-së sipërcituar dhe kanë sjellë zyrtarisht pranë Komisionit të Bashkisë procesverbalet me propozimet për nxënësit përfitues, shoqëruar me dokumentacionin përkatës sipas kritereve të VKM 666/2019.

Komisioni i Bashkisë bëri gjithashtu verifikimin e dokumentacionit shoqërues, lidhur me këto propozime si dhe shqyrtoi listat e ardhura me protokoll si më poshtë:

Shkolla e mesme profesionale "Charles Telford Erickson" Golem Kavajë me nr.1008 prot., datë 27.11.2025 protokolluar në Bashkinë Durrës me nr.14839 prot., datë 04.12.2025.
Shkolla mesme teknologjike "Hysen Çela" me nr.844 prot., datë 03.12.2025 protokolluar në Bashkinë Durrës me nr.14756 prot., datë 04.12.2025.
Shkolla mesme profesionale "Beqir Çela" me nr.858/1 prot., datë 03.12.2025, nr.858/2 prot., datë 03.12.2025 dhe nr.858/3 prot., datë 03.12.2025 protokolluar në Bashkinë Durrës me nr.14864 prot., datë 05.12.2025.

Numri I aplikimeve nga shkollat e mesme profesionale pranë Bashkisë Durrës është 339 nxënës. Propozohen pasi plotësojnë kriteret e VKM-së, mbështetur me dokumentacion 325 nxënës.

Kanë dorëzuar dokumentacionin nga shkolla profesionale "Charles Telford Erickson" 3 aplikantë

- Propozohen pasi plotësojnë kriterin të mbështetur me dokumentacion 2 aplikantë
- Ka mungesa në dokumentacion 1 aplikant

Kanë dorëzuar dokumentacionin nga shkolla teknologjike "Hysen Çela" 186 aplikantë

- Propozohen pasi plotësojnë kriterin të mbështetur me dokumentacion 182 aplikantë
- Kanë mungesa në dokumentacion 4 aplikantë

Kanë dorëzuar dokumentacionin nga shkolla profesionale "Beqir Çela" 150 aplikantë

- Propozohen pasi plotësojnë kriterin të mbështetur me dokumentacion 141 aplikantë
- Kanë mungesa në dokumentacion 9 aplikantë

Komisionet bënë shqyrtimin e bursave të nxënësve të vitit të parë që propozohen sipas pikës 9 të VKM 666/2019, të përditësuar, "Bursat e nxënësve të vitit të parë (klasën e 10) shqyrtohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak, sipas vendbanimit të përhershëm të prindit/nxënësit, përfitues të kuotës financiare/kuotës ushqimore (bursës).

Për sa më sipër, bazuar në VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të përditësuar, Komisioni vendosi t'i propozojë Këshillit Bashkiak sipas pikës 9 miratimin e listës emërore të nxënësve që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës për nxënësit e vitit të parë të shkollave të mesme profesionale "Beqir Çela" dhe "Charles Telford Erickson" në Golem Kavajë si dhe shkollës teknologjike "Hysen Çela". Për vitin shkollor 2025-2026 në vitin e parë kemi 65 nxënës aplikantë, propozohen për përfitim burse 58 pasi mbështeten me dokumentacionin përkatës sipas kriterëve.

III. Lista emërore e nxënësve të viteve të para që propozohen për përfitim burse për vitin shkollor 2025-2026, të shkollave të mesme profesionale "Beqir Çela", "Charles Telford Erickson" dhe shkolla teknologjike "Hysen Çela" të cilët plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës sipas VKM nr. 666/2019, të ndryshuar. Lista jepet në tabelën nr. 3 (vitet e para që propozohen si përfitues burse, me nr. rendor 1-58) bashkëlidhur.

Gjithashtu komisionet bënë shqyrtimin dhe propozojnë miratimin e bursave të nxënësve të vitit të dytë e lart sipas pikës 10.1 të VKM 666/2019, të përditësuar "Bursat e nxënësve për vitin e dytë e lart rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga Këshilli Bashkiak, sipas vendndodhjes territoriale e administrative të shkollave profesionale apo konvikteve ku janë vendosur nxënësit, përfitues të bursës/kuotës ushqimore, sipas planit të bursave të miratuara në vitin paraardhës nga Këshilli Bashkiak i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore".

Komisioni pas shqyrtimit vendosi t'i propozojë Këshillit Bashkiak sipas pikës 10.1 miratimin e listës emërore të nxënësve që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës për nxënësit e vitit të dytë e lart të shkollave të mesme teknologjike "Hysen Çela" dhe profesionale "Beqir Çela" për vitin shkollor 2025-2026. Për vitin shkollor 2025-2026 në vitin e dytë e lart, nxënës aplikues janë 274, propozohen për përfitim burse pasi mbështeten me dokumentacion 267 nxënës.

IV- Lista emërore e nxënësve të vitit të dytë e lart, që propozohen për përfitim burse për vitin shkollor 2025-2026, të shkollave të mesme profesionale "Beqir Çela" dhe teknologjike "Hysen Çela", të cilët plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës sipas VKM nr. 666/2019, të ndryshuar. Lista jepet në tabelën nr. 4 (viti i dytë e lart që propozohen si përfitues burse, me nr. rendor 1-267) bashkëlidhur.



Nxënësit që propozohen si përfitues të kriterëve të VKM nr. 666/2019 të ndryshuar, janë si më poshtë:


Kriteri	Nxënës përfitues /Viti parë	Nxënës që vazhdojnë bursën/Viti II e lart	Nxënës/ Gjithsej
Kriteri 2.2	6	15	21
Kriteri 2.1/a	-	56	56
Kriteri 2.3/a	-	1	1
Kriteri 2.3/c	-	10	10
Kriteri 2.3/d	6	49	55
Kriteri 2.3/dh	7	13	20
Kriteri 2.3/g	7	33	40
Kriteri 2.3/gj	21	70	91
Kriteri 2.4/a	11	20	31
Gjithsej	58	267	325

Gjithsej janë 325 nxënës të cilët propozohen për përfitues burse nga shkollat e mesme profesionale pasi plotësojnë kriteret e VKM 666/2019 të përditësuar nga të cilët kemi 20 nxënës që plotësojnë kriterin 2.3/dh të cilët përfitojnë dhe nga pika 20 (nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane të cilët ndjekin shkollat e mesme profesionale, përfitojnë falas veshmbathje, libra dhe fletore, sipas kuotës financiare të përcaktuar në pasqyrën nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi).

V- Miratimin e numrit të nxënësve dhe mësuesve për shkollën speciale PLM.

Gjithashtu, ky komision pranoi shkresën e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës me nr.2713 prot. datë 15.12.2025 protokolluar në Bashkinë Durrës me nr.15228 prot., datë 15.12.2025 ku përcaktohet se në shkollën speciale PLM Durrës numri i nxënësve të regjistruar është 103 nxënës dhe 7 fëmijë, si dhe 27 mësues+2 edukatore +1 psikolog, gjithsej 30 personel edukativ. Në shkollën speciale PLM për vitin shkollor 2024-2025 kemi 140 persona që përfitojnë nga VKM 666/2019 të përditësuar.

Sipas pikës 21 të VKM 666/2019, përcaktohet se “Nxënësit dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, me nevoja të veçanta psikosociale, pa konvikt, trajtohen me fonde të buxhetit të shtetit, me një kuotë ushqimore (drekë) me vlerë deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në ditë, sipas kuotës financiare të përcaktuar në pasqyrën nr. 4 që i bashkëlidhet këtij vendimi. Sipas pasqyrës nr. 4 “Për fëmijët e arsimit special” kuota financiare e veshmbathjes për një vit kalendarik është 7.000 (shtatë mijë) lekë në vit për vitin mësimor 2025-2026.







Komisioni me Relacionin “Për miratimin e listave emërore të nxënësve të arsimit parauniversitar, që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursave dhe pagesave për vitin shkollor 2025-2026”, në zbatim të pikës 32 të VKM nr. 666/2019 të ndryshuar, ku citohet se “Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të gjitha kategoritë e shkollave, është muaji dhjetor”, kërkon mirëkuptimin tuaj për miratimin e tyre.

Duke ju falenderuar,

KOMISIONI

Kryetar/
Egert HOXHA

Anëtar
Nikoleta RUSHA

Anëtar
Katerina NORJA

Anëtar
Elisabeta CIKO

Anëtar
Natasha Hysko